

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -



EKO KLUBI "YMER PRIZRENI"

1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i IAAP "Ymer Prizreni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

BOTA NË VORBULLËN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Ndryshimet Klimatike përfaqësojnë një fenomen shumë shqetësues si në nivel lokal, kombëtar, ndërkombëtar ashtu edhe për botën e gjallë dhe atë bimore. Ato përfshijnë jo vetëm rritjen e temperaturave, por edhe ngjarjet ekstreme të motit, rritjen e nivelit të detit, zhvendosjen e popullatave dhe habitateve të kafshëve të egra. Klima e planetit ka ndryshuar vazhdimisht gjatë kohës gjeologjike, me luhatje të konsiderueshme të temperaturave mesatare globale.

Megjithatë, kjo periudhë aktuale e ngrohjes po ndodh më shpejt se çdo ngjarje e kaluar. Për të fuqizuar jetën tonë moderne njerëzimi ka sakrifikuar mjedisin dhe mënyra sesi natyra po ja kthen duket se ka kosto tepër të lartë jo vetëm financiare e shëndetësore, por arrin deri në rrezikimin e ekzistencës njerëzore në tokë. Ndryshimi i klimës me ritme të shpejta po e bën të vështirë përshtatjen e gjallesave me temperaturat tepër të larta apo tepër të ulëta.



Ndryshimi i klimës është real dhe ndikimet janë serioze. Shkencëtarët kanë arritur në konsensusin se njeriu dhe veprimtaria e tij janë përgjegjës kryesorë të saj, prandaj edhe duhet të ndërmerren veprime konkrete dhe të shpejta. Ka shumë të ngjarë që valët e të nxehtit të ndodhin më shpesh dhe të zgjasin më shumë dhe, dukuritë e reshjeve ekstreme të bëhen më intensive e të shpeshta në shumë rajone. Oqeanet do vazhdojnë të ngrohen dhe acidifikohen dhe niveli mesatar global i deteve do vazhdojë të rritet. E gjithë kjo tashmë ka filluar dhe do ketë një ndikim shkatërrues në jetën e njeriut.

EFEKTET E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Ndryshimi i klimës ka efekte të ndryshme që shkaktojnë ndikime të ndryshme në:

Ekosistemet: Ndryshimi i klimës sulmon ekosistemet, duke zvogëluar biodiversitetin dhe duke e bërë të vështirë për shumë specie të mbijetojnë. Ai gjithashtu ndryshon depozitimin e karbonit në cikël dhe copëton habitatet e secilës specie. Habitatet e fragmentuara janë rreziqe të mëdha me të cilat duhet të përballen kafshët dhe bimët dhe që, disa herë, mund të nënkuptojnë zhdukjen e specieve.

Sistemet njerëzore: Për shkak të efekteve të pafavorshme që ka në atmosferë, reshje shiu, temperatura, etj. Ndryshimi i klimës sulmon sistemet njerëzore duke shkaktuar humbje të performancës në bujqësi. Për shembull, shumë kultura dëmtohen nga thatësira ekstreme ose nuk mund të rriten për shkak të temperaturave të larta, nevojitet një rotacion i të korrave, dëmtuesit rriten, etj. Nga ana tjetër, thatësira rrit mungesën e ujit të pijshëm për ujitje, furnizimin e qyteteve, larjen e rrugëve, zbukurimet, industrinë, etj. Dhe për të njëjtën arsye, kjo shkakton dëmtim të shëndetit, shfaqjen e sëmundjeve të reja ...

Sistemet urbane: Ndryshimi i klimës ndikon gjithashtu në sistemet urbane, duke bërë që modelet ose rrugët e transportit të modifikohen, teknologjitë e reja duhet të përmirësohen ose instalohen në ndërtesa dhe në përgjithësi ndikon në stilin e jetës

Sistemet ekonomike: Çfarë të themi për sistemet ekonomike. Padyshim, ndryshimet në klimë ndikojnë në marrjen e energjisë, prodhimin, industrive që përdorin kapital natyror ...

Sistemet sociale: Ndryshimi i klimës ndikon gjithashtu në sistemet shoqërore duke shkaktuar ndryshime në migrim, duke çuar në luftëra dhe konflikte, prishjen e barazisë, etj.





AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE
EC MA NDRYSHE



EKO KLUBI "YMER PRIZRENI"

RR. IMEHMET PASHË DEVALLA, PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".